

**Nr.61008-00347-00-2011 i Regj. Themeltar
Nr.00-2012-267 i Vendimit (60)**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Gani Dizdari	Kryesues
Arjana Fullani	Anëtare
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Edmond Islamaj	Anëtar
Shkëlzen Selimi	Anëtar

mori në shqyrtim në seancën gjyqësore të datës 29.02.2012, çështjen penale që i përket palëve:

KËRKUES: PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË
PERSONI NËN HETIM: ABDULSELAM TURGUT, përfaqësuar
nga av. Koli Bele

OBJEKTI:
Miratimin e arrestit të përkohshëm
dhe caktimin e masës shtrënguese “Arrest në Burg”
me afat 40 ditë për efekt ekstradimi
parashikuar nga neni 238 i K.Pr. Penale,
ndaj shtetasit turk Abduselam Turgut, i dtl. 27.05.1967,
me kombësi dhe shtetësi turke, mbajtës i pasaportës turke nr.U01132460.
Baza Ligjore: Neni 495 i K.Pr. Penale
dhe neni 16 i Konventës Evropiane për Ekstradimin.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.311 akti, datë 20.02.2011, ka vendosur:

Miratimin si të ligjshëm, të “Arrestit të përkohshëm” të shtetasit turk Abduselam Turgut, i datëlindjes 27.05.1967. Caktimin si masë shtrënguese për këtë shtetas, për efekt ekstradimi, atë të “Arrestit në Burg”, me afat 40 diëe, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin 118, datë 04.03.2011, ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit penal të masës së sigurimit nr.311 akti, datë 20.02.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke ndryshuar masën e sigurimit nga “Arrest në Burg”, me afat 40 ditë të parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale, në atë të “Arrestit në shtëpi” me afat 40 ditë në godinën e ndodhur në “Kthesën e Kamzës” Tiranë në katin e 8-të të shtetasit turk

Abdulselam Turgut. Urdhërohet lirimi i tij në qoftë se nuk mbahet për ndonjë shkak tjetër ligjor.

Kundër vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs Prokuroria e Apelit Tiranë, e cila kërkon: ndryshimin e vendimit penal nr.118, datë 04.03.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka ndryshuar masën e sigurimit personal, nga “Arrestit në burg” me afat 40 ditë në atë të “Arrestit në shtëpi” të shtetasit turk Abdulselam Turgut, duke parashtruar këto shkaqe:

- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë për sa i përket masës së sigurimit personal “Arrestit në shtëpi”, i caktuar në rastin konkret, është i papërshtatshëm në përputhje me rrezikshmërinë shoqërore mjaft të lartë të veprës.
- Vepra penale për të cilin po hetohet shtetasi Abdulselam Turgut nga organet e drejtësisë gjermane, ajo e shkeljes së ligjit për lëndët narkotike paraqet rrezikshmëri mjaft të lartë shoqërore, duke bërë të domosdoshëm izolimin e tij. Dispozita parashikon dënim maksimal 15 vjet burg.
- Nga ana tjetër duhet të merret në konsideratë fakti se kjo masë siguri vendoset për të mundësuar realizimin e procesit të ekstradimit në shtetin kërkues.
- Gjykata ka gabuar edhe kur ka marrë në konsideratë gjendjen shëndetësore të shtetasit turk Abdulselam Turgut, për të cilën ky informacion duhej të merrej nëpërmjet një rruge procedurale me ekspertizën përkatëse.
- Akti mjeko ligjor ka ardhur në Shqipëri nga shteti turk, ndërkohë që shtetasi Abdulselam Turgut rezulton të jetojë në Shqipëri.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarës Arjana Fullani; përfaqësuesin e personit nën hetim, av. Koli Bele, të caktuar kryesisht nga gjykata, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit; prokurorin Kujtim Luli, i cili kërkoi pranimin e rekursit, prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; si dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes

Nga aktet e administruara në dosje rezulton se Organi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 19.02.2001, ka dërguar pranë Gjykatës së Tiranës kërkesën për miratimin e arrestit të përkohshëm dhe caktimin e masës shtrënguese “arrest me burg” 40 ditë për efekt ekstradimi për shtetasin Abdulselam Turgut.

Ka rezultuar se në datën 18.02.2011, rreth orës 15.00, nga kontrolli i personave që hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga linja ajrore “Turkish Airlines”, është bllokuar shtetasi turk Abdulselam Turgut. Ky veprim është kryer për arsye se shtetasi turk Abdulselam Turgut, sipas INTERPOLIT, ka rezultuar me statusin “I kërkuar – me qëllim arrestimi ” e në këto kushte, pas kontaktit të Ministrisë së Rendit Publik me Zyrën Qendrore Kombëtare të Interpol – Tirana, nga kjo e fundit është konfirmuar me një e-mail se ky shtetas është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol -Wiesbaden (Gjermani) me urdhërin European të arrestit të lëshuar në datën 21.09.2009, me akuzën e “trafikimit të heroinës, opiumit” me qëllim ekstradimin e këtij shtetasi në Gjermani, pasi kjo vepër sipas nenit 53 të Kodit Penal Gjerman paraqet rrezikshmëri mjaft të lartë shoqërore dhe dënohet me 15 vjet burgim.

Nga shërbimet e policisë gjyqësore është bërë verifikimi i saktë i shtetasit dhe faqja e e-mail-it, në të cilin kërkohet arrestimi i tij, me qëllim ekstradimi në Gjermani e në këto kushte është bërë arrestimi i përkohshëm i shtetasit Abdulsalam Turgut.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.311 akti, datë 20.02.2011, ka vendosur: *“Miratimin si të ligjshëm, të “Arrestit të përkohshëm” të shtetasit turk Abdulsalam Turgut, i datëlindjes 27.05.1967. Caktimin si masë shtrënguese për këtë shtetas, për efekt ekstradimi, atë të “Arrestit në Burg”, me afat 40 ditë, parashikuar nga nenin 238 i K.Pr.Penale...”*

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin 118, datë 04.03.2011, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit penal të masës së sigurimit nr.311 akti, datë 20.02.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke ndryshuar masën e sigurimit nga “Arrest në burg”, me afat 40 ditë të parashikuar nga nenin 238 të K.Pr.Penale, në atë të “Arrestit në shtëpi” me afat 40 ditë në godinën e ndodhur në “kthesën e Kamzës” Tiranë, në katin e 8-të, të shtetasit turk Abdulsalam Turgut. Urdhërohet lirimi i tij në qoftë se nuk mbahet për ndonjë shkak tjetër ligjor..”*

Arsyetime i gjykatës: *“.....Gjykata e apelit, në vështrim të ... nenit 494 dhe 495 të K.Pr.Penale, si dhe njëkohësisht e në mbështetje të Konventës Europiane “për ekstradimet” nr.024...ratifikuar me ligjin nr.8322, datë 02.04.1998, dhe dy protokolleve shtese ka bërë verifikimin e të gjithë provave ... dhe në frymën e dispozitave të lartpërmendura ka arritur në konkluzionet e mëposhtme. Nga ana e organit të prokurorisë rezulton se kemi shkelje të nenit 494/1 të K.Penal, pasi në rastin konkret nuk kemi një kërkesë të shtetit të huaj të paraqitur në formën e kërkuar nga ligji dhe që kjo kërkesë t’i jetë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë... dhe të jetë bërë pjesë e kësaj dosje. Sipas kësaj dispozite (nenit 494/1 të K. Penal) ...pasi të jenë plotësuar këto kërkesa ... gjykata “mund” të vendosë përkohësisht një masë shtrënguese përpara se të vijë kërkesa e ekstradimit. Kjo dispozitë jep në mënyrë taksative se mbasi të plotësohen këto kërkesa është në disponimin e gjykatës mbështetur në të dhënat dhe provat e tjera të vendosë nëse mund të jepet e theksojmë faktin se thuhet “gjykata mund” këtë masë të shtrëngimit të përkohshëm. Sipas “Protokollit të dytë shtesë të konventës Evropiane mbi Ekstradimet të vitit 1978 e ratifikuar ...në paragrafin 1 të nenit 12 të Konventës theksohet se “Kërkesa duhet të jetë me shkrim dhe duhet t’i adresohet Ministrisë së Drejtësisë së kërkuar nga ministria kërkuese...Mjetet dhe rrugët e tjeramund të bëhen me marrëveshje midis dy palëve...Në rastin konkret gjykata nuk varen asnjë nga këto raste...Rezulton se materiali administruar është e-mail midis Policisë Kufitare Rinas dhe Zyrës Ndërkombëtare të Interpolit. Në vështrim të nenit 494/2 ... duhet të plotësohen tre kritere që duhet të merret kjo masë e sigurimit personal të përkohshëm. ...Referuar sa më sipër dhe mbështetur në Konventën Europiane “Mbi Ekstradimet” dhe dy protokollat shtese për të cilat shteti është palë, konventë e cila për nga hierarkia ka epërsi mbi Kodin e Procedurës Penale...nuk janë plotësuar disa kritere ligjore të sipërcituara dhe për më tepër nuk është plotësuar dhe kërkesat e nenit 16 të Konventës Europiane “Mbi ekstradimet” nën ky që i referohet nenit 12 paragrafi 2.a të po kësaj Konvente. Sipas tij kërkesa për “arrest provizor” duhet patjetër të provohet me një nga dokumentat e përmendura në nenin 12 paragrafi 2.a të kësaj konvente, i cili kërkon domosdoshmërisht origjinalin apo kopjen autentike të vendimit të dënimit apo të urdhër arrestit të zbatueshëm ...me dispozitat procedurale të ligjit të palës së kërkuar.....Rezulton nga provat e dosjes ...se nga ana e organit të prokurorisë nuk është paraqitur asnjë vendim origjinal apo kopje identike e vendimit të arrestit, vendim të dënimit*

apo kërkesë për qëllime ekstradimi nga ana e shtetit gjerman pranë autoriteteve gjyqësore shqiptare, por i gjithë materiali është fotokopje dhe i nxjerrë nga interneti.....Nuk rezulton në asnjë material të dosjes që të ketë komunikim zyrtar midis Zyrës Kombëtare të Interpol Tiranës dhe Zyrës Ndërkombëtare të Interpolit qoftë dhe një komunikim nëpërmjet e-mailit. ... Gjykata e Apelit Tiranë çmon se organi i prokurorisë arrestimin nga data 18.02.2011, ...dita e shpalljes së vendimit në Gjykatën e Tiranës deri në ditën e marrjes së këtij vendimi nga ana e kësaj gjykate, e kishte kohën e mjaftueshme prej 14 ditësh t'i plotësonte kërkesat e nenit 494 dhe 495 të K.Pr.Penale dhe nenit 12 dhe 16 të Konventës Europiane, por nuk i ka plotësuar ato.Nga provat dhe pretendimet e palëve në proces rezulton se personi nën arrest të përkohshëm, Abdulselam Turgut, është me banim të përkohshëm e Shqipëri dhe për këtë ka paraqitur një kontratë qirajeSipas shkresës me nr.0180-2011-0535457, datë 23.02.2011 të Kryeprokuratës Republikane të Stambollit se shtetasi turk Abdulselam Turgut nuk është nën hetim dhe nuk është gjykuar. Gjithashtu sipas shkresës me nr.1254, datë 15.01.2011, të spitalit Yasam Universal është arritur në konkluzionin se “Abdulselam Turgut është parë e mundur që gjithmonë të përdorë barna dhe gjendet nën rrezik jetësor dhe që vuan nga mosmjaftimi i zemrës dhe hiperlipidemi....”

Kundër vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka ushtruar rekursë, Prokuroria e Apelit Tiranë, e cila kërkon ndryshimin e vendimit penal nr.118, datë 04.03.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka ndryshuar masën e sigurimit personal, nga “Arrestimi në burg” me afat 40 ditë në atë të “Arrestit në shtëpi”, të shtetasit turk Abdulselam Turgut.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi i gjykatës së apelit lidhur me masën e sigurimit të caktuar të pandehurit është i drejtë dhe i bazuar në ligj e për këtë shkak duhet të lihet në fuqi.

Instituti i Ekstradimit përcaktohet dhe rregullohet në nenet 488 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në Konventën e Këshillit të Europës për Ekstradimin dhe dy protokolleve shtesë të saj, miratuar me ligjin nr.8322, datë 02.04.1998.

Si Konventa, ashtu edhe dispozitat e ligjit penal, parashikojnë dhe lejojnë arrestimin/ndalimin e personave për të cilët ekziston një kërkesë për arrestim të përkohshëm me qëllim ekstradimin, si masë provizore e cila mund të vendoset për të garantuar ekstradimin. Ky arrestim/ndalim mund të kërkohet në bazë të një kërkesë formale të shtetit të huaj, e cila nga Ministria e Drejtësisë nëpërmjet prokurorit pranë gjykatës kompetente i paraqitet gjykatës dhe kërkon vendosjen përkohësisht të një mase shtrënguese para se të vijë kërkesa e ekstradimit (neni 494 i K.Pr.Penale). Përgjashtimisht nga rregulli i mësipërm, në raste të ngutshme, arrestimi/ndalimi i personit mund të realizohet edhe prej Policisë Gjyqësore (neni 495 i K.Pr.Penale).

Ky Kolegj vlerëson se në ndryshim nga sa arsyeton gjykata e apelit ndalimi i personit nën hetim është kryer nga policia gjyqësore në bazë të ligjit dhe në zbatim të tij. Ky arrestim bazohej në një kërkesë për arrestim me qëllim ekstradimi që figuronte në sistemin elektronik të INTERPOLIT, kërkesë e cila parashikohet si mënyrë komunikimi në nenin 16, paragrafi 3 të Konventës për Ekstradimin (*Kërkesa për arrestim të përkohshëm do t'u transmetohet autoriteteve kompetente të palës së kërkuar ose me rrugë diplomatike ose drejtpërdrejt me postë, ose me telegram, ose nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale INTERPOL...*). Nga ana tjetër, vendosje e kësaj mase siguri provizore parashikohet si në nenin 16, paragrafi 1 të Konventës për Ekstradimin (*Në raste urgjente autoritetet kompetente të palës kërkuese mund të kërkojnë arrestimin e përkohshëm të individit që kërkohet; autoritetet kompetente të palës së kërkuar vendosin për këtë kërkesë në përputhje me ligjin e*

kësaj pale), ashtu edhe në legjislacionin e brendshëm (neni 495, paragrafi 1 i K.Pr.Penale që parashikon se: “Në rastet e ngutshme, policia gjyqësore mund të bëjë arrestimin e personit, kundër të cilit është paraqitur kërkesa për arrestimin e përkohshëm.....”

Rezulton gjithashtu se Autoritetet Policore, Prokuroria, Gjykata dhe Ministria e Drejtësisë kanë ndjekur hapat e parashikuara nga neni 16, paragrafi 2 dhe 3 i Konventës për Ekstraditim dhe neni 495, paragrafi 2 3, 4 dhe 5 i K.Pr.Penale për aplikimin, miratimin dhe njoftimin e kësaj mase provizore (**Konventa për Ekstraditim** “2. Në kërkesën për arrestim të përkohshëm do të shënohet ekzistenca e njërit prej dokumenteve të parashikuara në paragrafin 2, kryerreshti a i nenit 12, dhe do të theksohet se për këtë do të dërgohet një kërkesë për ekstradim; aty do të përmendet shkëlja për të cilën do të kërkohet ekstradimi, koha dhe vendi ku është kryer ajo, si dhe brenda mundësive të dhënat rreth individit që kërkohet..... Autoriteti kërkues do të njoftohet pa vonesë lidhur me rrugën që i është dhënë kërkesës së tij. 4. Arrestimi i përkohshëm mund të marrë fund në rast se brenda një afati prej 18 orësh pas arrestimit, Pala e kërkuar nuk ka marrë njoftim për kërkesën e ekstradimit dhe për dokumentet shoqëruese që përmenden në nenin 1, 2; në asnjë rast ajo nuk duhet të kalojë përtej 40 ditëve pas arrestimit. Sidoqoftë, lirimi i përkohshëm është i mundshëm në çdo kohë, por pala e kërkuar duhet të marrë çdo masë që e quan të nevojshme për të shmangur arratisjen e individit të kërkuar. 5. Lirimi nuk përjashton një arrestim të dytë dhe ekstradimin në rast se kërkesa për ekstradim mbërrin më vonë.... **K.Pr.Penale** “2. Autoriteti që ka bërë arrestimin njofton menjëherë prokurorin dhe Ministrin e Drejtësisë. Brenda dyzet e tetë orëve prokurori e ve të arrestuarin në dispozicion të gjykatës në territorin e së cilës është bërë arrestimi, duke i dërguar edhe dokumentacionin përkatës. 3. Gjykata, brenda dyzet e tetë orëve nga arrestimi e miraton atë, kur janë kushtet ose vendos lirimin e të arrestuarit. Për vendimin që merr ajo njofton Ministrin e Drejtësisë. 4. Masa e arrestit revokohet në qoftë se Ministria e Drejtësisë nuk kërkon, brenda dhjetë ditëve nga miratimi, mbajtjen e saj. 5. Kopja e vendimit të dhënë nga gjykata për masat shtrënguese dhe sekuestrimet, në bazë të këtyre neneve, u njoftohet prokurorit, personit të interesuar dhe mbrojtësit të tij, të cilët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit”.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se gjykatat e të dyja shkallëve për efekt të caktimit të masës provizore të sigurimit për efekt ekstradimi në çdo rast duhet të kenë parasysh dhe aplikojnë nenin 493, paragrafi 2 të K.Pr.Penale, i cili parashikon se: “Në caktimin e masave shtrënguese respektohen dispozitat e titullit V të këtij Kodi, për aq sa mund të zbatohen, duke mbajtur parasysh kërkesat për të garantuar që personi për të cilin është kërkuar ekstradimi të mos i shmanget dorëzimit”.

Është pikërisht ky qëllim final i Konventës, garantimi i ekstradimit të personit në rast se gjykata kompetente e vendit nga do të bëhet ekstradimi vendos përfundimisht për dhënien e ekstradimit, i cili duhet mbajtur parasysh nga gjykatat në përcaktimin dhe miratimin e masës shtrënguese më të përshtatshme, e cila në çdo rast nuk limitohet në aplikimin apriori të masës së sigurimit “arrest në burg” duke përjashtuar të gjitha masat e tjera, për shkak se kjo masë garanton më së shumti që personi nuk do t’i shmanget ekstradimit.

Në rastin në shqyrtim rezulton se personi i ndaluar dhe për të cilin kërkohet vendosja e një mase shtrënguese për efekt sigurimi është një shtetas turk, i cili ka qenë në Shqipëri edhe herë të tjera. Në ditën e ndalimit nga autoritetet e pikës së kalimit kufitar në Aeroportin “Nënë Tereza” rezulton që ky shtetas ka fluturuar nga Turqi dhe nuk figuron të jetë ndaluar nga autoritetet Turke të cilat gjithashtu kanë qenë në dijeni të “Urdhër Arrestit Ndërkombëtar lëshuar nga Autoritetet Gjermane në bazë të një vendimi gjykate të vitit 2009”, i cili ndodhej në sistemin elektronik të INTERPOL, urdhër arresti i cili u drejtohej të gjitha shteteve

anëtare të kësaj organizate. Në dosje ndodhen të administruara edhe një shkresë e Prokurorisë së Bakirkoy/Stamboll, e cila konfirmon se ky shtetas turk nuk është në hetim apo gjykim për vepra penale, si dhe një raport mjekësor i cili tregon se personi nën hetim është person i rrezikuar nga shëndeti pasi vuan nga zemra (Hiperlipidemit). Për më tepër ky shtetas nuk është ndaluar nga autoritetet shqiptare, ndonëse rezultojnë që të ketë hyrë në territorin shqiptar edhe në vitin 2010, vit në të cilin ka nënshkruar edhe një kontratë qiraje për një apartament banimi.

Ky Kolegj vlerëson se në caktimin e masës shtrënguese të sigurimit, përcaktuar në nenin 232 të K.Pr.Penale, gjykatat e të dyja shkallëve duhet të vlerësonin “përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret” (neni 229/1 i K.Pr.Penale). Në aktet e administruara në dosje në momentin e shqyrtimit të kërkesës nga gjykata e apelit nuk rezultojnë e provuar ekzistenca e shkaqeve (të përcaktuara në nenin 228/3 të K.Pr.Penale), të tilla që të legjitimojnë organin e akuzës të kërkojë dhe më pas gjykata të caktojë masën e sigurimit “Arrest në burg” si të vetmen masë të posaçme, veçanërisht në kushtet kur nuk u arrit të provohej se çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të të pandehurit.

Ky Kolegj vlerëson se, për shkak të rrethanave të çështjes në momentin e shqyrtimit të saj nga gjykata e apelit, masa e sigurimit “arrest në shtëpi” konsiderohet e përshtatshme lidhur me nevojat e sigurimit, në raport me hetimet që do të kryhen dhe karakteristika e personit nën hetim dhe rrethanat e tjera.

Ky Kolegj vlerëson t’i tërheqë vëmendje gjykatës që në zbatim të nenit 237, pika 1 të K.Pr.Penale nuk ka bërë kujdes për verifikimin e një adrese më të detajuar banimi dhe nuk e ka shoqëruar caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” me urdhërimin e të pandehurit të mos largohet nga vendi i caktuar ku ai banonte, ndonëse ka verifikuar dhe evidentuar faktin se atij i është bllokuar pasaporta nga autoritetet shqiptare dhe se ka ngarkuar policinë gjyqësore për ekzekutimin e vendimit, në zbatim të nenit 237, pika 3 të K.Pr.Penale “Prokurori dhe policia gjyqësore kontrollojnë respektimin e urdhrave që i janë dhënë të pandehurit”.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 441 të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S I

Lënien në fuqi të vendimit nr.118, datë 04.03.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Tiranë, më 29.02.2012

**Kundër
Shkëlzen SELIMI**